



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:219406  
Datë: 02.12.2019  
Numri i dokumentit: 00685210

**C.nr. 1021/16**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtarin Enver Shabanaj në çështjen juridike-kontestuese lidhur me kompensimin e diferencës në pagë të paditësit F.G. nga P., përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokati N.H. nga P., B.D. e K. Nr. .../A-..., kundër të paditurit T. i K. Sh.A. me seli në Prishinë – Lagjja D. p.n. pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, në datën 07.11.2019, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit F.G. nga P. kundër të paditurit T. i K. Sh.A me seli në P., me të cilën ka kërkuar kompensimin nga diferenca në pagë në mes të gradës 5 për pozitën “N.D.” dhe gradës 7 për pozitën “Udhëheqës i D.”, shkak të performancës së detyrave të punës nga grada 7, në periudhën kontestuese nga data 10.10.2013 deri në datën 17.11.2018, dhe atë për diferencën në paga shumën 9’433.90 euro (neto), për kumatën ligjore shumën 2’597.72 euro, për kontributin pensional shumën 2’072.12 euro dhe për tatimin në paga shumën 1’048.21 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi (personalisht dhe përmes përfaqësuesit me prokurë) përmes padisë së paraqitur në gjykatë, deklarimeve gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe gjatë seancave të mbajtura ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek i padituri, në pozitën e punës “N.D.” me kontratën e lidhur në afat të pacaktuar kohor, datë 19.03.2013 nr. 842/13, me gradë të pagesës 5. Që nga data 10.10.2013 deri në datën 17.11.2018 – kur edhe është pensionuar, paditësi ka pretenduar se ka kryer detyrat e punës për pozitën “U. i D.”, pozitë kjo e cila paguhet sipas gradës 7. Për këtë arsye, në bazë të kalkulimeve nga ekspertiza financiare, pretendon se i takon kompensimi për diferencën në paga në mes të gradës 5 dhe 7 në shumën 9’433.90 euro (neto), për kumatën ligjore në shumën 2’597.72 euro, për kontributin pensional në shumën 2’072.12 euro dhe për tatimin në paga në shumën 1’048.21 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri në përgjigjen në padi si dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancat gjyqësore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit në teresi si të pa bazuar. Pala e paditur nuk e ka mohuar ekzistencën e marrëdhënies së punës, mirëpo ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për shkak se i njëjti nuk ka paraqitur prova bindëse mbi bazën e të cilës do të dëshmojë avancimi në pozitën e Udhëheqësit të deposë apo delegimi i përgjegjësive të punës me ndonjë akt të brendshëm të punëdhënësit, sipas të cilit paditësit do t'i takonte kompensimi i kërkuar. Në mungesë të provave ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në procedurën e provave me pajtimin e palëve ndërgjyqëse është bërë administrimi i provave, dhe nga provat e gjithëmbarshme të lëndës si me të rëndësishmet gjykata nxori: 1. Kontrata e punës nr.01-824/13 dt. 19.03.2013, 2. Përshkrimi i detyrave dhe lidhjeve raportuese – pjesë përbërëse e kontratës, 3. Urdhëri për ngarkesë i datës 08.11.2013, 4. Urdhëri për ngarkesë i datës 01.10.2013, 5. Lista e mjeteve themelore e regjistrimit e datës 17.10.2013, 6. Raporti i Komisionit për regjistrimin e gjendjes në depo tek e paditura datë 12.01.2018 – bashkëngjitur me kërkesën për pulla postare e datës 20.08.2018, 7. Procesverbali mbi gjendjen e deposë të vlerave postare nga Inspektorati Postar i datës 05.09.2019, 8. Lista e regjistrimit për lëndë të parë për depon 007 për formularë dhe etiketa e datës 05.01.2018, 9. Raporti për paraqitje në Komision disiplinor i datës 13.12.2008, 10. Aktvendimi për largim të përkohshëm të punëtorit – paditësit nga e paditura datë 03.12.2008, 11. Aktvendimi për dënim me të holla për paditësin datë 22.06.2009, 12. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension i datës 09.08.2019, 13. Procesverbali mbi praninë – dorëzimin e vlera postare i datës 10.10.2013, 14. Parashtrësia e datës 07.03.2019 nga përfaqësuesi i paditësit, 15. Ekspertiza financiare e datës 13.09.2019, 16. Parashtrësia për deklaram në ekspertizë nga paditësi e datës 25.09.2019.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse **nuk ishte kontestues** fakti se paditësi ka qenë i punësuar tek i padituri deri në momentin e pensionimit si “N.D. – Grada 5, dëshmuar sipas deklaratave të palëve ndërgjyqëse në seanca të mbajtura dhe shkresa të lëndës si dhe provat e gjithëmbarshme të administruara.

Nga deklaramet e palëve ndërgjyqëse në procedurë, për paditësin **vazhdon të jetë kontestuese** fakti se punëdhënësi T. i K. nuk i ka kompensuar të ardhurat mujore në harmoni me performimin e përgjegjësive të pozitës “U. i D.” – Grada 7.

Paditësi duke konsideruar se i takon e drejta në kompensimin e diferencës në paga për periodën kontestuese 10.10.2013 deri në datën 17.11.2018 – kur edhe është pensionuar, është dëmtuar nga mos realizimi të ardhurave mujore që i përkasin gradës 7, dhe për këtë kishte parashtruar padi në gjykatë. Lartësinë e kërkesëpadisë paditësi e ka caktuar / precizuar sipas shumës së caktuar nga ekspertiza financiare për këtë çështje.

Gjykata pas vlerësimit të deklaramëve të palëve ndërgjyqëse dhe shqyrtimit të secilës provë veç e veç, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit sipas dispozitave të ligjit të punës është e pa bazuar nga se:

Paditesi ka qenë i punësuar tek i padituri dhe e ka nënshkruar me te paditurin – e cila ishte valide në perioden kontestuese, nr. 824/2013 datë 19.03.2019 e lidhur në kohë të pacaktuar, me gradë 5. Mirëpo i njejtë në bazë të provave që ka prezentur ka pretenduar t'i njihet kompensimi nga diferenca në pagë me gradën 7 për shkak se pretendon të ketë ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të deposë. Gjykata i konsideron si të pamjaftueshme provat e praqitura nga paditësi (Provat e administruara Nr. 3 – 8) të pamjaftueshme për aprovim të kërkesëpadisë sepse me këto nuk i'u dëshmuua bindshëm gjykatës se gjatë periudhës kontestuese, paditësi në mënyrë konsistente dhe kontinuele ka ushtruar funksionin e udhëheqësit të deposë.

Në shqyrtimin e provave gjykata konstaton se duke pasur parasysh se barra e provave bie mbi paditësin – para gjykatës nuk është prezentuar ndonjë akt juridik i punëdhënësit në formë të shkruar me të cilin në mënyrë ligjore paditësi është ngarkuar me përgjegjësitë e udhëheqësit të deposë dhe që është emëruar udhëheqës, apo ndonjë akt tjetër i punëdhënësit me të cilin i njihet përgjegjësia dhe llogaridhënia në cilësi të udhëheqësit të deposë në periudhën kontestuese në mënyrë konsistente dhe kontinuele.

Duke konsideruar se Kontrata e Punës në mes të palëve ndërgjyqëse nr. 824/2013 datë 19.03.2019 e lidhur në kohë të pacaktuar, është lidhur në pajtim me dispozitat nga Ligji i Punës së Kosovës - Neni 10 dhe 11 për lidhjen e një kontrate, dhe se e njëjta është nënshkruar nga te dyja palet ndërgjyqëse, dhe se pagat mujore janë përcaktuar konform nenit 55 të Ligjit të Punës me gradën 5, Gjykata konstaton se pretendimet e paditësit nuk janë mbështetur me prova të mjaftueshme për një vendosje në favor të pretendimeve të tij. Nga kjo dhe në baze të provave që i janë ofruar gjykatës deri me tani nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë. Themelimi i mardhenies se punes, te drejtat dhe detyrimet e paleve, e edhe pagat janë përcaktuar dhe realizuar sipas kontratës së lartëcekur ne pajtim me nenin 55 te Ligjit te Punes.

Nga këto, në bazë të çmuarjes së lirë të provave gjykata gjeti se padia e paditësit është e pabazuar dhe nuk u thellua në shqyrtimin pretendimeve të tjera të palëve, duke gjetur se provat e administruara ishin të mjaftueshme për një vendosje të tillë.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që secila nga palët ndërgjyqëse t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës. Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr. 1021/16, datë 07.11.2019**

**Gjyqtari**  
**Enver Shabanaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.